



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:228463

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876691

KPPP.nr.1707/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “ISEFERI” SH.P.K., me numër unik identifikues 810106204, me seli në Suharekë, Zona Industriale, Shirokë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Qazim Hasanaj nga Suhareka, kundër debitorit “ERDI-B” SH.P.K., me numër unik identifikues 811253468, me seli në fshatin Nakardë, Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.524/2023 të datës 20.09.2023 të Përmbartuesit Privat Liridon H. Tërshani, me seli në Prizren, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “ERDI-B” SH.P.K., dhe Urdhri P.nr.524/2023 i datës 20.09.2023 i Përmbartuesit Privat Liridon H. Tërshani, MBETET NË FUQI.
- II. OBLIGOHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbartim dhe përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 208€ në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “ISEFERI” SH.P.K., ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.524/2023 të datës 20.09.2023 me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës 22-SHV01-001-44 të datës 16.06.2022 dhe Faturës 22-SHV01-001-62 të datës 06.07.2022, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 2,830€ me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën e plotë si dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit përmes

bllokimit të të gjitha llogarive bankare dhe regjistrohet, konfiskohet dhe shitet pasuria e debitorit si në sende të luajtshme po ashtu edhe paluajtshmëri të tjera në tërë masën pasurore të debitorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se urdhëri është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi që i njëjti është lëshuar në bazë të faturave të cilat nuk i plotësojnë kushtet e dokumentit të besueshëm siç përcaktohet me nenin 38 të LPP-së. Po ashtu ka theksuar se dokumentet nuk janë të përshtatshme për përmbarim pasi që faturat nuk janë pranuar nga debitori dhe nuk përmbajnë vulën e debitorit. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të shfuqizojë urdhrin përmbarimor.

Kreditore në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuara pasi që debitori nuk ka përmendur asnjërin nga shkaqet për të cilat paraqitet prapësimi. Ka shtuar se prapësimi nga debitori është paraqitur vetëm për të prolonguar çështjen pasi që nuk ka dhënë arsye të besueshme dhe konkrete si dhe nuk ka kundërshtuar borxhin por ka paraqitur pretendimin që faturat nuk janë të vullosura, për çfarë si provë ka dorëzuar dy fletë dërgesa të mallit me të cilat dëshmohet që malli i faturuar është dorëzuar tek debitori, andaj gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë 208 euro për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar*

kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.
Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.*

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbarimor P.nr.524/2023 i datës 20.09.2023 bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht Faturës 22-SHV01-001-44 të datës 16.06.2022 dhe Faturës 22-SHV01-001-62 të datës 06.07.2022, në lartësi të përgjithshme prej 2,830€, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata gjen se faturat mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim në lidhje me faktin se faturat nuk përmbajnë vulën e debitorit gjykata i vlerësoi si të pabazuara pasi që faturat në bazë të cilave është iniciuar procedura përmbarimore janë të pranuar nga debitori që vërtetohet nga nënshkrimi i vendosur në faturë dhe nuk është kusht që faturat të jenë edhe të vulosura.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi sipas nenit 452 par.1 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e arritur në procedurën gjyqësore, ashtu që vendosi që të obligoj debitorin që kreditorit ti paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë 104 euro në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim dhe 104 në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim, kjo në përputhje me tarifën e OAK – përmbarimi në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë mbi lartësinë e kontestit të vlerës së vogël.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr. 1707/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.